



## LISTA KONTROLLUESE E PUNËDHËNËSIT PËR VETËVLERËSIM

|                                            |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                   |
|--------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>PJESA 2:</b>                            | <b>RREZIQET NË PUNË</b>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                           |
| <b>Tema 2.1.</b>                           | <b>RREZIQET FIZIKE</b>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                            |
| <b>Nën-tema 2.1.5.</b>                     | <b>NDRIÇIMI</b>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                   |
| <b>Ligji / rregulloret përkatëse:</b>      | <ul style="list-style-type: none"><li>• Ligji Nr.04/L-161 për sigurinë dhe shëndetin në punë;</li><li>• Rregullore (MPMS) Nr.01/2020 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (MPMS) Nr.04/2014 për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit në vendin e punës;</li><li>• Rregullore (MPMS) Nr.04/2014 për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit në vendin e punës;</li><li>• Rregullore (MPMS) Nr.02/2020 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (MPMS) Nr.05/2014 për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit në përdorimin e pajisjeve të punës në vendin e punës;</li><li>• Rregullore (MPMS) Nr.05/2014 për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit në përdorimin e pajisjeve të punës në vendin e punës.</li></ul> |
| <b>Shkurtesa:</b>                          | <ul style="list-style-type: none"><li>• MPMS – Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale</li></ul>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                 |
| <b>Fushëveprimi i listës kontrolluese:</b> | Kjo listë kontrolli është e zbatueshme në të gjitha industritë dhe sektorët nën fushën e zbatimit të Ligjit Nr.04 / L-161 për "Sigurinë dhe Shëndetin në Punë", pavarësisht nga forma e organizimit, lloji i pronësisë dhe arsyet mbi të cilat puna ose trajnimi kryhen në vendet e punës ku ekziston rrezik për shëndetin për shkak të ndriçimit.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                |
| <b>Përdorimi i listës së kontrollit:</b>   | Nëse përgjigjeni "Po" në një pyetje, ju lutemi kaloni në pyetjen tjetër, në rast se përgjigjeni "Jo" bëni vërejtje që mund të ndërmerren veprime për të përmbushur kërkesat ligjore.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                              |

| Nr. | Pika e kontrollit                                                                                                                                                                                                                                                                                                                               | Po | Jo | Vërejtje për zbatim |
|-----|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----|----|---------------------|
|     | <b>PARA VIZITËS NË LOKACION / VENDET E PUNËS</b>                                                                                                                                                                                                                                                                                                |    |    |                     |
|     | <i>* Meqenëse bëhet fjalë për vetë inspektim, apo vetëvlerësim të situatës në subjektin tuaj nga rreziqet fizike – ndriçimi, do të ishte mirë që ekipi i inspektimit paraprakisht ta ketë në shqyrtim dokumentin e vlerësimit të riskut, atëherë do të ketë njohuri të afërta me rreziqet dhe masat e përcaktuara, të cilat duhet apo është</i> |    |    |                     |

|    |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                           |  |  |  |
|----|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--|--|--|
|    | <i>dashur të ndërmerren nga punëdhënësi për mënjanimin, respektivisht minimizimin e tyre.</i>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                             |  |  |  |
|    | <b>INSPEKTIMI I LOKACIONIT / VENDEVE TË PUNËS</b>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                         |  |  |  |
|    | <p><i>* Gjatë vizitës në vendpunishte / vendin e punës, duhet t'i kushtoni vëmendje të punësuarve që janë të ekspozuar në vende të punës me rrezik ndaj ndriçimit duke i vëzhguar, duke u përgjigjur në pyetjet e përpiluara, duke vëzhguar duke bërë matje dhe duke fotografuar.</i></p> <p><i>* Bisedoni me të punësuarit, tregohuni miqësor, shpjegoni dhe këshilloni për të drejtat e tyre sipas legjislacionit.</i></p>              |  |  |  |
| 1. | <p><b>A janë rrugët dhe daljet e emergjencës të pajisura me ndriçim të sigurt dhe me intensitet të përshtatshëm në rastet e ndërprerjes së energjisë elektrike?</b></p> <p>Rregullore (MPMS) Nr.01/2020, Neni 8</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Verifikohet intensiteti i rrymës nga vlerësimi të riskut në atë vend pune dhe nëse nuk është në përputhje merren masat adekuate administrative.</li> </ul>                   |  |  |  |
| 2. | <p><b>A janë dritaret, çatitë prej xhami, dhe ndarëset prej xhami të ndërtuara ose të përshtatura për të shmangur efektet e diellit, duke pasur parasysh llojin e punës dhe vendin e punës?</b></p> <p>Rregullore (MPMS) Nr.04/2014, Shtojca I, 7.3</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Së pari ekipi i inspektimit bënë matjet e ndriçimit në kohën e caktuar, duke pasur parasysh llojin e punës dhe vendin e punës</li> </ul> |  |  |  |
| 3. | <p><b>A kanë vendet e punës ndriçim natyral të mjaftueshëm dhe a janë të pajisura me ndriçim artificial të përshtatshëm për mbrojtjen e sigurisë dhe shëndetit të punësuarve dhe personave të tjerë?</b></p> <p>Rregullore (MPMS) Nr.01/2020, Neni 13</p>                                                                                                                                                                                 |  |  |  |

|    |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                     |  |  |  |
|----|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--|--|--|
|    | <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Ekipi i inspektimit duhet të verifikojë sasinë e ndriçimit natyral, dhe të verifikojë se ndriçimi artificial është i përshtatshëm për mbrojtjen e sigurisë dhe shëndetit të punësuarve dhe personave të tjerë.</i></li> </ul>                                                                                                                                                                                           |  |  |  |
| 4. | <p><b>A e pengon ose ndikon ndriçimi artificial në ngjyrat e shenjave dhe sinjaleve të sigurisë dhe shëndetit në vendin e punës?</b></p> <p>Rregullore (MPMS) Nr.01/2020, Neni 13</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Ekipi i inspektimit duhet të verifikojë se a ndikon negativisht ndriçimi artificial në ngjyrat e shenjave dhe sinjaleve të sigurisë dhe shëndetit në vendin e punës.</i></li> </ul>                                               |  |  |  |
| 5. | <p><b>A janë vendosur dhe siguruar dritare dhe dritë natyrore nga burime të tjera, në mënyrë që hapësira e punës të mbrohet nga ekspozimi i tepërt ndaj diellit, duke pasur parasysh llojin e punës?</b></p> <p>Rregullore (MPMS) Nr.01/2020, Neni 13</p>                                                                                                                                                                                                           |  |  |  |
| 6. | <p><b>A janë pajisur vendet e punës me ndriçim natyror dhe me ndriçim artificial në mënyrë që ndriçimi i përgjithshëm të jetë adekuat për sigurinë dhe shëndetin e punëtorëve ?</b></p> <p>Rregullore (MPMS) Nr.01/2020, Neni 14</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Gjithmonë gjatë verifikimit të përshtatshmërisë së ndriçimit, këtë më së miri e deklarojnë të punësuarit, se a ndihen të rehatshëm gjatë punës lidhur me ndriçimin.</i></li> </ul> |  |  |  |
| 7. | <p><b>A janë vendosur në mënyrë të sigurt instalimet për ndriçimin e mjedisit të punës dhe rrugëve të kalimit?</b></p> <p>Rregullore (MPMS) Nr.04/2014, Shtojca I, 8.2</p>                                                                                                                                                                                                                                                                                          |  |  |  |
| 8. | <p><b>A janë të pajisura me ndriçim emergjence me intensitet të mjaftueshëm vendet e punës dhe zonat e tjera ku punëmarrësit</b></p>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                |  |  |  |

|     |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                              |  |  |  |
|-----|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--|--|--|
|     | <p><b>dhe personat e tjerë janë të ekspozuar në mënyrë të veçantë ndaj rreziqeve në rastin të ndërprerjes së ndriçimit artificial?</b></p> <p>Rregullore (MPMS) Nr.04/2014, Shtojca I, 8.3</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Ekipi i inspektimit e vërteton këtë te masat e përcaktuara nga vlerësimi i riskut.</i></li> </ul> |  |  |  |
| 9.  | <p><b>A janë muret transparente apo që lejojnë depërtimin e dritës të pajisura me shenja dalluese dhe të ndërtuara me materiale të sigurt?</b></p> <p>Rregullore (MPMS) Nr.04/2014, Shtojca I, 9.3</p>                                                                                                                                       |  |  |  |
| 10. | <p><b>A përdoren në mënyrë të sigurt dritaret dhe çatitë prej xhami të vendeve të punës, në mënyrë që të mos shkaktojnë rreziqe për punëmarrësit përreth ndërtesës?</b></p> <p>Rregullore (MPMS) Nr.04/2014, Shtojca I, 10.1</p>                                                                                                             |  |  |  |
| 11. | <p><b>A janë pajisur me ndriçim të mjaftueshëm natyral ose/dhe artificial mjediset e pushimit?</b></p> <p>Rregullore (MPMS) Nr.01/2020, Neni 20, 16.2</p>                                                                                                                                                                                    |  |  |  |
| 12. | <p><b>A janë vendet e punës në mjedise të hapura të ndriçuara me ndriçim të përshtatshëm artificial, nëse ndriçimi natyral nuk është i mjaftueshëm, në pajtim me Tabelën 3 të rregullores 01/2020?</b></p> <p>Rregullore (MPMS) Nr.01/2020, Neni 25</p>                                                                                      |  |  |  |
| 13. | <p><b>A pastrohen vazhdimisht pjesët e palëvizshme të ndriçimit, dritaret dhe pajisjet e tjera të ndriçimit, në mënyrë që të sigurohet një nivel i mjaftueshëm i sigurisë dhe higjienës?</b></p>                                                                                                                                             |  |  |  |

|     |                                                                                                                                                                                                                                        |  |  |  |
|-----|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--|--|--|
|     | Rregullore (MPMS) Nr.04/2014, Neni 5, 1.4                                                                                                                                                                                              |  |  |  |
| 14. | <b>Instalimet dhe pajisjet elektrike, a kryhen nga shërbimet dhe personat që kanë kualifikimet dhe kapacitetet e nevojshme?</b><br><br>Rregullore (MPMS) Nr.01/2020, Neni 6, 3.4                                                       |  |  |  |
| 15. | <b>A janë pajisjet e punës të projektuara për përdorim gjatë natës apo në vende të errëta të pajisura me ndriçim të përshtatshëm për kryerjen e punës në mënyrë të sigurt?</b><br><br>Rregullore (MPMS) Nr.05/2014, Shtojca I, 3.1.6.5 |  |  |  |
| 16. | <b>Nivelet e ndriçimit të brendshëm në varësi të vendit të punës dhe llojit të punës a janë përshtatur sipas standardi ISO 8995 "Ndriçimi vendeve të punës"?</b><br><br>Rregullore (MPMS) Nr.01/2020, Tabela 2                         |  |  |  |
| 17. | <b>Nivelet e ndriçimit të jashtëm në varësi të vendit të punës dhe llojit të punës a janë përshtatur sipas standardi ISO 8995 "Ndriçimi vendeve të punës"?</b><br><br>Rregullore (MPMS) Nr.01/2020, Tabela 3                           |  |  |  |